



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prof. 132 / 1

Tiranë, më 18.02.2021

Thirrje për pjesëmarrje

Në konkursin për çmimet shkencore që jepen nga Akademia e Shkencave, sipas vendimit nr. 14, datë 18.02.2021 të Kryesisë

1. Mbështetur në vendimin e Kryesisë nr. 14, datë 18.02.2021 Për organizimin e konkursit për çmimet shkencore kombëtare që jepen nga Akademia e Shkencave, ftohen për të marrë pjesë dhe konkurruar me veprat/punimet/projektet e tyre studiues dhe institucione të interesuara brenda dhe jashtë vendit, sipas specifikave të çmimeve në vijim:
 - a. Çmimi shkencor kombëtar *Eqrem Çabej*, për veprën më të mirë në fusha të shkencave shoqërore dhe albanologjike;
 - b. Çmimi shkencor kombëtar *Petrit Radovicka*, për veprën/punimin/projektin më të mirë në fusha të shkencave natyrore-teknike;
 - c. Çmimi shkencor ndërkombëtar *Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli*, për albanologët e huaj që kanë realizuar vepra me rëndësi madhore për gjuhën, lashtësinë, vazhdimësinë, identitetin, trashëgiminë kulturore dhe historinë e shqiptarëve;
 - ç. Çmimi shkencor kombëtar i *Karrierës*, për personalitete të dijes akademike, krijimtarisë dhe kulturës kombëtare, në shenjë nderimi për kontributet e tyre përgjatë jetës krijuese;
 - d. Çmimi shkencor i veçantë *Aleks Buda*, për studiuesit e rinj më të suksesshëm.

2. Kërkesa për pjesëmarrje

2.1 Institucionet akademike-universitare dhe strukturat pranë tyre, duke përfshirë njësitë bazë të kërkimit, që janë autorë apo propozues të veprave për konkurrim; si dhe botuesit dhe subjekte të tjerë propozues; ose autorët e vetëpropozuar, paraqesin pranë Akademisë së Shkencave dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kërkesën / propozimin e motivuar me shkrim;
- b. Deklaratën e autorit/autorëve për pranimin e kushteve të konkurrimit;
- c. *Curriculum vitae* dhe listën e botimeve shkencore;
- ç. Për veprat me shumë autorë paraqitet dhe lista e plotë e autorëve;
- d. Dy kopje të studimit / projektit të botuar, me ISBN të viteve 2019 dhe 2020, që pas konkursit bëhen pjesë e bibliotekës shkencore të Akademisë;
- dh. Për raste aplikimesh/shpikjesh në fusha të shkencave teknike dhe natyrore edhe certifikatën e regjistrimit të veprës/punimit/projektit /patentës dhe dëshminë prej autoritetit miratues të tyre;
- dh. Deklaratën e autorësisë/originalitetit të veprës/punës shkencore;
- ë. Një përmbledhje analitike në anglisht të veprës;
- f. Kur konkurruesi është institucion, paraqiten dhe: një kopje e statutit dhe dokumenti i regjistrimit si person juridik. Në rastin e konkurrimit sipas kësaj pike, dy rekomandime prej institucionesh të specializuara kërkimore akademike-universitare janë të mirëpritura.

3. Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit pranë zyrës së protokoll-arkivit dhe në sekretarinë e jurisë është deri më 31 qershor 2021.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prot. 132

Tiranë, më 18.02.2021

Vendim

Nr. 14, datë 18.02.2021

Për organizimin e konkursit për çmimet shkencore kombëtare që
jepen nga Akademia e Shkencave

Në zbatim të nenit 7, pika 8 të Ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; të nenit 25 pika 8 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të nenit 11 të rregullores Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre, Kryesia e Akademisë së Shkencave, bazuar në pikën 2 të vendimit nr. 3 datë 29.01.2021 të Asamblesë Për miratimin e raportit të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2020 dhe të programit të saj për vitin 2021,

Vendosi:

1. Shpalljen e konkursit për çmimet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si më poshtë:
 - a. Çmimi shkencor kombëtar *Eqrem Çabej*, për veprën më të mirë në fusha të shkencave shoqërore dhe albanologjike;
 - b. Çmimi shkencor kombëtar *Petrit Radovicka*, për veprën / projektin / punimin më të mirë në fusha të shkencave natyrore-teknike;
 - c. Çmimi shkencor ndërkombëtar në albanologji *Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli*, që jepet për albanologë të huaj që kanë realizuar vepra me rëndësi madhore për gjuhën, lashtësinë, vazhdimësinë, identitetin, trashëgiminë kulturore dhe historinë e shqiptarëve;
 - ç. Çmimi shkencor kombëtar i *Karrierës*, që jepet për merita akademike shkencore për personalitete të dijes, krijimtarisë e kulturës kombëtare, në shenjë nderimi, për kontributet e tyre përgjatë jetës krijuese;

d. Çmimi shkencor i veçantë *Aleks Buda*, që jepet për studiuesit e rinj më të suksesshëm për vepër monografike ose artikull shkencor të botuar në revista me indeksim ndërkombëtar dhe faktor impakti.

2. Për çmimet shkencore sipas germave *a*, *b* dhe *d* të pikës 1 pranohen për konkurrim vepra të botuara gjatë viteve 2019-2020, sipas përcaktimeve në *Thirrjen për pjesëmarrje*, bashkëlidhur këtij vendimi. Afati i fundmë i dorëzimit të veprave konkurruese është deri më 31 qershor 2021. Për çmimin shkencor ndërkombëtar në albanologji *Meyer-Pedersen-Jokli* pranohen për konkurrim vepra të botuara në periudhën 2011-2020.

3. Fituesit e çmimeve shkencore sipas germave pikave *c* dhe *ç* të pikës 1 do të shpallen në muajin nëntor, në ditët e Kuvendit Ndërkombëtar të Albanologjisë. Çmimet sipas shkronjave *a*, *b* dhe *d* të pikës 1 do të shpallen në muajin mars 2022.

4. Për të gjitha kategoritë e çmimeve ngrihet një juri e vetme.

5. Kalendari i konkurrimit është si vijon:

Juria e ngritur për këtë konkurs shpall listën e plotë të autorëve dhe veprave të regjistruara jo më vonë se data 31 korrik 2021.

Brenda datës 10 gusht 2021 juria zgjedh e nominon jo më shumë se 3 (tri) vepra/kandidatë për çdo çmim. Në të njëjtën datë juria shpall kalendarin e ligjëratave të të nominuarve, që paraqiten në periudhën shtator-tetor. Për autorët konkurrues për çmimet sipas shkronjave *a*, *b* dhe *d* të pikës 1 ligjëratat përruese do të zhvillohen në periudhën dhjetor 2021-janar 2022.

6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetarët e seksioneve dhe juria.

7. Për përlllogaritjen dhe kryerjen e detyrimeve financiare që burojnë nga ky vendim ngarkohen: kancelari dhe shërbimi i financës.

8. Specialisti i marrëdhënieve me jashtë dhe publikun ngarkohet për të njoftuar e ftuar për pjesëmarrje institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat e albanologjisë jashtë vendit, sipas përshkrimit në rregulloren e çmimeve sipërpërmendur.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR